

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija-
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.13/2024

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbardimore në lëndët përmbardimore, P.nr.1067/19, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Burbuqe Spahija -Kërveshi, pala ankuese nga komuna e në mungesë të përmbarduesit privat, me datë 07.11.2024, mori këtë:


V E N D I M

REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-13/2024 i datës 31.07.2024, si dhe ankesa e palës ankuese nga komuna e e datës 16.07.2024, **si të pabazuara.**

Përmbarduesi Privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore, P.nr.1067/19.

A r s y e t i m

Pala ankuese, nga komuna e përmes të autorizuarit të tij me datë 16.07.2024, ka parashtruar ankesë ndaj përmbarduesit privat pasi sipas ankesës, përmbarduesi privat ka bërë shkelje për lëndën P.nr.1067/19, ngase pala kreditore nuk ka asnjë njohuri se cilat veprime janë ndërmarrë nga përmbarduesi privat dhe se i njëjti si përmbardues me qëllim ka ekzekutuar aktgjykimin e plotëfuqishëm dhe sipas atij aktgjykimi kreditori ka qenë i dëmtuar nga debitori



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija-
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.13/2024

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushë Karaçi kryesuesë, Adnan Konushevi dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.1067/19, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija -Kërveshi, pala ankuese nga komuna e në mungesë të përmbaruesit privat, me datë 07.11.2024, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-13/2024 i datës 31.07.2024, si dhe ankesa e palës ankuese nga , komuna e e datës 16.07.2024, **si të pabazuara.**

Përmbaruesi Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore, P.nr.1067/19 .

A r s y e t i m

Pala ankuese, nga , komuna e përmes të autorizuarit të tij me datë 16.07.2024, ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit privat pasi sipas ankesës , përmbaruesi privat ka bërë shkelje për lëndën P.nr.1067/19 ,ngase pala kreditore nuk ka asnjë njohuri se cilat veprime janë ndërmarrë nga përmbaruesi privat dhe se i njejt si përmbarues me qëllim ka ekzekutuar aktgjykimin e plotëfuqishëm dhe sipas atij aktgjykimi kreditori ka qenë i dëmtuar nga debitori

Pala ankuese ka shprehur që do të merr ato mjete duke ditur vendimin e gjykatës dhe atë brenda një afati të arsyeshëm kohor, pasi përmbauesi nuk i ka kryer veprimet lidhur me përbarimin e aktgjykimit dhe me këtë ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 367 të LPP-së.

I ka propozuar komisionit që në përputhje me dispozitat e nenit 373 të LPP-së, të aprovohet ankesa dhe, ndaj përmbauesit të ndërmirren masa adekuate .

Përmbauesi Privat, në përgjigjen e tij, ka deklaruar se tek ky rast janë ndërmarrë disa veprime përbarimore, si dalje dhe bllokim të xhirlogarive bankare, por urdhëri për bllokim të këtyre llogarive lidhur me këtë lëndë, ka qenë jo me prioritet , pasi ka pasur bllokime paraprake nga përmbaues tjerë dhe urdhëresa tjera para këtij rasti.

Për këtë është njoftuar pala dhe e ka pasur të njohur këtë fakt, por pala ankuese ka kërkuar vetëm kompenzimin dhe pagesat duke mos pasur parasysh gjendjen e debitorit lëndor.

Për këtë ka ofruar si prova urdhërat dhe kërkesat që janë bërë për debitorin dhe përgjigjen e bankave ku shihen prioritete dhe bllokime paraprake për këtë debitor.

I ka propozuar komisionit që ankesa të refuzohet si e pabazuar, pasi nuk ka shkelje disiplinore.

Në seancën dëgjimore ka munguar përmbauesi privat dhe seanca është mbajtur duke u bazuar në përgjigjen e tij dhe provat e ofruara, ndërsa pala ankuese në seancë ka deklaruar se mbetet si në pretendimet në ankesë dhe sipas tij ka njohuri që përmbauesi ka vepruar, por ai duke shpresuar në atë kompenzim , nuk ka asnjë mundësi e të hyra tjera, ashtuqë ka mbetur duke pritur këtë kompenzim.

Komisioni nuk ka gjetur ndonjë provë me të cilën do të provohej që përmbauesi privat ka bërë shkelje ligjore sipas pretendimeve në ankesë dhe nuk ka mundur të vërtetohet me provat e ofruara ndonjë shkelje ligjore, pasi nga provat e ofruara shihet se përmbauesi privat ka ndërmarrë veprimet përbarimore me qëllim të përbarimit të rastit, por gjendja financiare e debitorit ka pamundësuar realizimin e kërkesës kreditore dhe para urdhërave për bllokim të përmbauesit këtu, debitori ka disa bllokime paraprake, kështuqë nga kjo situatë, ka mbetur pa u finalizuar kompenzimi dhe përbarimi deri në një mundësi pagese nga ana e debitorit.

Mbi këtë bazë nuk ka pasur neglizhencë dhe mosveprime nga përmbauesi sikurse ka pretenduar pala ankuese.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.12/2024 datë 07.11.2024

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.